

# Prioritetet e buxhetit të Kosovës para pandemisë COVID-19

Maj 2020







---

# Prioritetet e buxhetit të Kosovës para pandemisë COVID-19

MAJ 2020

**Deklaratë mohimi:**

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Institutit GAP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur

Origjinali është shkruar në shqip.

Ky publikim është mbështetur nga:



Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4, 10000 Prishtinë  
+383 38 609 339  
info@institutigap.org

---

# Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive 6

1. Hyrje 8

2. Të gjeturat kryesore 9

3. Përfundim 26

# Përmbledhje ekzekutive

Për shkak të vonesave në formimin e qeverisë, buxheti i Kosovës për vitin 2020 ishte miratuar jashtë afateve të rregullta ligjore. Gjithashtu, koha brenda së cilës deputetët e Kuvendit të Kosovës është dashur që ta shqyrtojnë këtë dokument tejet të rëndësishëm, ka qenë e pamjatueshme për një analizë të mirëfilltë të tij. Prandaj, qëllimi i këtij raporti është që të bëjë një analizë ex-post të ndarjeve të miratuara buxhetore për vitin 2020, para goditjes nga pandemia COVID-19. Instituti GAP do të bëjë një analizë të ndarë sa i përket ndryshimeve në buxhetin e Kosovës si pasojë e kësaj krize.

Në buxhetin e vitit 2020 ishte planifikuar një përshpejtim i rritjes së shpenzimeve krahas të hyrave, gjë që ka reflektuar një rritje të nevojës për financim. Mirëpo, deficitin buxhetor ishte brenda rregullës fiskale. Krahasuar me buxhetin e vitit paraprak, është planifikuar që nevoja për financim të mbulohet më shumë nga burimet e jashtme, duke e zvogëluar varësinë në fondet e privatizimit dhe letrat me vlerë. Për dallim nga viti i kaluar kur kishim një rritje të hovshme të shpenzimeve rrjedhëse, veçanërisht në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, këtë vit ishte planifikuar një rritje shumë më e shpejtë e shpenzimeve kapitale. Mirëpo, një pjesë më e madhe e investimeve kapitale do të financohen nga klauzola e investimeve, por duke pasur parasysh nivelin e ulët të realizimit nga financimi i jashtëm, rrezikohet që një pjesë e këtyre projekteve të mbesin të parealizuar. Ngjashëm sikurse vitet e kaluara, shumica dërrmuese e projekteve kapitale qendrore janë vazhdim apo obligime nga vitet e kaluara, duke lënë pak hapësirë për projekte të reja. Gjithashtu, edhe prioritetet sipas fushave kanë mbetur të njëjta me vitin e kaluar, ku më shumë se gjysma e shpenzimeve orientohen për çështjet ekonomike, mbrojtje sociale dhe arsim.

Në anën tjetër, sa i përket shpenzimeve rrjedhëse, ato kanë mbetur pothuajse të njëjta me vitin e kaluar. Mirëpo, në rast të hyrjes në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik, atëherë nuk dihet sa sa mund të rriten këto shpenzime, duke pasur parasysh se kostoja e saktë e ligjit nuk dihet ende.

Këtë vit është bërë një organizim i ri i ministrive, rrjedhimisht edhe ministrinë të cilat menaxhojnë pjesën më të madhe të buxhetit kanë ndryshuar. Tri ministrinë me buxhetin më të madh janë Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT), Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit (MIA). Për dallim nga vitet e kaluara, këtë vit kemi një rënie të theksuar të buxhetit për ndërtim të autostradave dhe rehabilitim të rrugëve, por megjithatë MIA do ta menaxhojë gati gjysmën e buxhetit qendror për investime kapitale.

Sa i përket investimeve kapitale nga niveli qendror në atë lokal, edhe këto investime kapitale në pjesën më të madhe janë vazhdimësi nga viti i kaluar. Këtë vit shihet një shpërndarje më e balancuar e këtyre investimeve në komuna, duke përjashtuar Komunën e Prishtinës, ku shohim një diskriminim pozitiv më të madh të ndarjes së investimeve kapitale krahas numrit të popullsisë dhe territorit.

Sa i përket ndarjes sipas kategorizimit funksional, buxheti për shëndetësi është rritur por është ende i ulët në proporcion me madhësinë e ekonomisë krahasuar me shpenzimet në vendet e BE-së. Edhe buxheti për arsim është rritur krahasuar me vitin paraprak dhe mesatarja në këtë sektor del të jetë mbi mesataren e shpenzimeve të BE-së në krahasim me madhësinë e ekonomisë.

Shuma e ndarë për pensionet dhe kompensimet tjera sociale në vitin 2020 është rritur lehtë, ku pjesa më e madhe është paraparë për pensionet kontributdhënëse dhe bazike. Por, mbetet të shihet deri në fund të vitit se çfarë do të ndodhë me kategorinë e pensioneve të veteranëve, ngase në vitet e kaluara ka pasur devijim të madh nga shuma e planifikuar. Rritje të buxhetit është planifikuar edhe për Agjencinë e Punësimit, për programin e shërbimeve të punësimit. Tek Inspektorati i Punës është ndarë buxhet vetëm për 90 persona, ndërsa në programin e qeverisë, stafi i këtij departamenti parashihet të jetë 400 persona apo rreth 4.4 herë më i madh.

Krahasuar me vitin paraprak, buxheti për Radio Televizionin e Kosovës (RTK) ka rënë dhe gjithashtu forma e alokimit të mjeteve ka ndryshuar. Bazuar në raportet financiare të këtij institucioni, Komisioni paralementar për buxhet dhe transfere do të marrë vendim në baza tre-mujore lidhur me ndarjen e mjeteve për RTK-në.

- ● Ngjashëm sikurse vitet e kaluara, shumica dërrmuese e projekteve kapitale qendrore janë vazhdime apo obligime nga vitet e kaluara, duke lënë pak hapësirë për projekte të reja. Gjithashtu, edhe prioritetet sipas fushave kanë mbetur të njëjta me vitin e kaluar, ku më shumë se gjysma e shpenzimeve orientohen për çështjet ekonomike, mbrojtje sociale dhe arsim

# Hyrje

Për shkak të vonesave në arritjen e koalicionit qeverisës nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2019, krahasuar me afatin e rregullt ligjor, Qeveria e Kosovës e dorëzoi projekt buxhetin e Kosovës për vitin 2020 me rreth katër muaj vonesë në Kuvendin e Kosovës. Nga dita e shpërndarjes së projektbuxhetit në kuvend deri në datën e miratimit, deputetët e kuvendit kanë pasur vetëm tri ditë kohë që ta shqyrtojnë këtë dokument që ka rreth 550 faqe. Afatet e rregullta ligjore për shqyrtimin e projektbuxhetit nga kuvendi, lejojnë rreth 60 ditë kalendarike për shqyrtim të këtij dokumenti nga ana e kuvendit. Përderisa vonesat në draftimin e buxhetit ishin si pasojë e mosmarrëveshjeve politike, urgjenca në miratimin e buxhetit erdhi si pasojë e krizës shëndetësore dhe ekonomike që pritej të shkaktohej nga COVID-19. Kosova si edhe një pjesë e madhe e shteteve tjera në botë, filloi të goditet nga kriza e COVID-19, dhe Qeverisë së Kosovës i duhej urgjent një buxhet i miratuar në mënyrë që të mund ta menaxhonte më lehtë aspektin shëndetësor të kësaj krize. Për këtë arsye, projektbuxheti i vitit 2020 u miratua në dy lexime brenda natës.<sup>1</sup>

Qëllimi i këtij raporti është që të analizojë ex-post ndarjet e miratuara për vitin 2020. Përveç ku theksohet ndryshe, ndarjet e buxhetit për vitin 2020 janë analizuar me ndarjet aktuale 2019. Duke marrë parasysh që kriza e COVID-19 ka ndryshuar supozimet mbi të cilat është përgatitur ky dokument dhe ndarjet buxhetore, atëherë buxheti i vitit 2020 pritet të pësojë një numër ndryshimesh sa i përket të hyrave, financimit dhe ndarjeve buxhetore. Për këtë arsye, Instituti GAP do të përgatisë një analizë të ndarë lidhur me ndikimin e COVID-19 në buxhetin e Kosovës për vitin 2020.

---


<sup>1</sup> Kuvendi i Kosovës, Procesi legjislativ për projektligjin për buxhetin e vitit 2020, Burimi: <https://bit.ly/2WInCsw>



# Të gjeturat kryesore

**Nevoja për financim është rritur ndërsa deficitit buxhetor ishte brenda rregullës fiskale.** Shpenzimet buxhetore gjatë vitit 2020 janë planifikuar të jenë rreth 2.35 miliardë euro, gjë që është 266 milionë euro apo 13% më shumë se sa në vitin 2019.<sup>2</sup> Të hyrat planifikohet të jenë për 131 milionë euro (7%) më të mëdha krahasuar me vitin 2019 dhe kjo paraqet një trend të njëjtë me periudhën paraprake (2018/2019). Për dallim nga viti 2019, ku 90% e shpenzimeve ishin financuar nga të hyrat buxhetore, në projektbuxhetin e vitit 2020 këto të hyra financojnë 86% të shpenzimeve. Nevoja për financim është rritur nga 203 milionë euro (2019) në 337 milionë euro që shënon një rritje prej 134 milionë euro apo 66%. Mirëpo, nëse krahasojmë me planifikimin e buxhetit për vitin 2019, atëherë nevoja për financim ka rënë për 92 milionë euro apo 21%. Në vitin 2019, deficitit buxhetor ishte financuar në masë të madhe nga financimi i brendshëm - nga shpenzimi i njëhershëm i fondeve të privatizimit dhe letrat me vlerë. Në vitin 2020, ky trend është planifikuar të ndryshojë, ngase financimi i jashtëm pritet të rritet për 98 milionë euro ndërsa financimi i brendshëm të bie për 53.4 milionë euro (20%).


**Figura 1.** Struktura e financimit të buxhetit



**Shpenzimet kapitale ishin planifikuar të rriten më shpejt se ato rrjedhëse.** Krahasuar me periudhën paraprake 2018/2019, kur shpenzimet kapitale nuk kanë ndryshuar pothuajse fare, për vitin 2020 janë planifikuar të rriten për 141 milionë euro apo 27%. Ndërkaq, shpenzimet rrjedhëse janë rritur më ngadalë në krahasim me periudhën 2019/2018 - 116 milionë euro apo 8% më shumë, ndërsa në vitin 2019 kishte rritje prej 137 milionë euro apo 10% më shumë.


<sup>2</sup> Aty ku nuk përmendet ndryshe, të dhënat e buxhetit për vitin 2020 janë krahasuar me të dhënat aktuale për vitin 2019 ashtu siç i ka paraqitur Ministria e Financave.

**Figura 2.** Rritja e shpenzimeve rrjedhëse dhe kapitale



**Financimi i shpenzimeve kapitale nga të hyrat buxhetore dhe kaluzola e investimeve është rritur.** Sa i përket financimit të shpenzimeve kapitale, në projektbuxhetin 2020 shihet se 76% e shpenzimeve kapitale do të financohen nga buxheti i rregullt, gjë që shënon një rritje prej 32% krahasuar me shpenzimet akutale në vitin 2019. Financimi i investimeve kapitale nga klauzola e investimeve është planifikuar të rritet me afro pesë herë në vlerë krahasuar me vitin paraprak.<sup>3</sup> Për dallim, financimi nga fondet e likuidimit të AKP-së do të bie për 47 milionë euro apo 35% nga viti 2019.

**Figura 3.** Financimi i shpenzimeve kapitale




<sup>3</sup> Krahasuar me planifikimin e vitit 2019 financimi i investimeve kapitale nga kaluzola e investimeve ka rënë për 44 milionë euro apo 57%. Shih analizën e Institutit GAP për më shumë sa përket planifikimit të buxhetit për vitin 2019, Vegza: <https://bit.ly/2xKOCuG>

### Shpenzimet rrjedhëse në bazë të kategorive ekonomike kanë mbetur pothuajse të njëjta me vitin paraprak.

Gjatë vitit 2020, pritet që shpenzimet rrjedhëse si pagat dhe mëditjet dhe subvencionet dhe transferet mos të kenë ndryshime të mëdha në krahasim me vitin paraprak. Mirëpo, në rast të hyrjes në fuqi të Ligjit për paga në sektorin publik, MFT ka ndarë 34.2 milionë euro buxhet rezerva për paga dhe mëditje për nivel komunal, prandaj kjo kategori ekonomike mund të rritet gjatë vitit. Gjithashtu, duke marrë parasysh që rritja nominale e Bruto Produktit Vendor (BPV) ishte rreth 5% në vitin 2018, rritja e planifikuar për paga dhe mëditje është nën kufirin e lejuar sipas kufirit të vendosur në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, mirëpo në rast të hyrjes në fuqi të Ligjit për paga në sektorin publik ky rregull do të tejkalohej.<sup>4</sup> Kontributin më të madh në rritjen e shpenzimeve rrjedhëse në buxhetin e vitit 2020 do ta bëjnë rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime me 63 milionë euro më shumë – pjesërisht edhe si pasojë e riklasifikimit të rreth 9 milionë eurove nga shpenzimet kapitale në mallra dhe shërbime, dhe rritja e rezervave rrjedhëse me 44 milionë euro më shumë.


Figura 4. Rritja e shpenzimeve rrjedhëse



4 Ligji nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194. Burimi: <https://bit.ly/3dkuKFR>


**Prioritet e shpenzimeve kanë mbëtur të njëjta me vitin e kaluar.** Ngjashëm me vitin e kaluar tri prioritetet kryesore në buxhetin e Kosovës janë: çështjet ekonomike, mbrojtja sociale dhe arsimi. Krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar, këtë vit shihet një rritje më e theksuar e buxhetit për arsim prej rreth 29 milionë euro (8%), rend dhe siguri publike prej 13.3 milionë euro (7%) si dhe mbrojtje prej 10.6 milionë euro (18%). Ndërsa ndarjet për çështje ekonomike dhe mbrojtje të mjedisit kanë pësuar një rënie prej 103 milionë (18%) dhe 17.1 milionë euro (40%) respektivisht.

**Figura 5.** Ndarjet funksionale si përqindje e shpenzimeve



**Është ulur buxheti i ministrive.** Për shkak të ndryshimeve të bëra, nga viti 2020 qeveria do të ketë vetëm 15 ministri pasi që gjashtë ministri të mëhershme janë shkrirë ose bashkuar me ministri tjera. Këtë vit, ministrinë do të menaxhojnë me rreth 1.43 miliardë euro apo 61% të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2020. Ky buxhet është më i ulët se ai i vitit 2019, ku 21 ministrinë së bashku kanë menaxhuar me rreth 1.49 miliardë euro apo 5% (62 milionë euro) më shumë.<sup>5</sup> Shpenzimet kapitale përbëjnë 31.8% të buxhetit të ministrive këtë vit ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga shpenzimet rrjedhëse sikurse subvencionet dhe transferet me 41.6%, pagat dhe mëditjet me 13.5%, mallrat dhe shërbimet me 12%, shpenzimet komunale me 0.8% dhe rezervat me 0.2%. Tri ministrinë që do të menaxhojnë me më shumë buxhet janë Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT) me 544 milionë euro, Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit (MIA) me 244 milionë euro dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP) me 160 milionë euro. Në MFT, 86% e buxhetit është e alokuar në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, konkretisht për pensionet dhe kompenzimet, ndërsa në MIA mbi 89% e buxhetit është e alokuar për shpenzimet kapitale. Kurse, në MPBAP mbi gjysma e buxhetit (51%) është ndarë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve meqë nga kjo ministri paguhen numri më i madh i punonjësve (11,060).

**Figura 6.** Buxheti i ministrive në vitin 2020




5 Ministria e Financave. Ligji nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Burimi: <https://bit.ly/3a3lnbX>



**Gati gjysma e buxhetit për investime kapitale do të menaxhohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit.** Nga buxheti i ndarë për shpenzime kapitale për ministritë prej 453 milionë euro, Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit do të menaxhojë me gati gjysmën e tyre, rreth 48% apo 217 milionë euro. Mirëpo, siç tregon Figura 6, buxheti i ndarë për shumicën e departamenteve dhe programeve që e mbulojnë pjesën e infrastrukturës është më i ulët se në 2019. Konkretisht, është ulur buxheti për shpenzime kapitale i programit për ndërtimin e autostradave për 65% apo 49 milionë euro dhe buxheti i programit për rehabilitimin e rrugëve për 47% apo 53 milionë euro. Rritje më të theksuar të buxhetit për shpenzime kapitale, për 79% apo rreth 10 milionë, në vitin 2020 ka për zyrën për shpronësim.


Me nga 8.3% të buxhetit të shpenzimeve kapitale do të menaxhojnë MPBAP (37.7 milionë euro) dhe Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS me 37.5 milionë euro).

**Figura 7.** Buxheti i disa departamenteve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit, 2019-2020




**Rreth 90% e investimeve kapitale të nivelit qendror janë vazhdim nga viti 2019.** Në buxhetin e vitit 2020, nga 501 milionë euro të ndara për investime kapitale nga niveli qendror, rreth 450 milionë euro apo 90% janë investime kapitale që janë projekte shumëvjeçare të vazhduara nga viti 2019. Vetëm 51 milionë euro apo 10% janë investime kapitale të reja që reflektojnë programin e qeverisë aktuale. Në buxhetin e kaluar, shkalla e projekteve që ishin vazhdim nga 2018 në 2019 ishte më e ulët, rreth 82%.

**Figura 8.** Investimet e reja kapitale dhe të vazhduara nga niveli qendror




Në nivel të ministrive, janë ndarë vetëm 43 milionë euro për investimet kapitale të reja për vitin 2020. Si rrjedhojë, numri i projekteve kapitale të reja është shumë i vogël. Në disa raste edhe mjetet e ndara si të reja në 2020, janë shuma shtesë për projektet shumëvjeçare nga 2019. Rreth një e treta e kësaj shume ka shkuar për MFT-në, ku 13.2 milionë euro janë paraparë për detyrime kontigjente dhe 2.2 milionë euro për shlyerjen e obligimeve të ATK sipas vendimeve gjyqësore. Ndërkaq, tek Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit (MIA), si investime të reja në 2020 janë kryesisht disa projekte që mbulohen nga klauzola e investimeve, sikurse ndërtimi i impjanteve të ujërave të zeza në Gjilan (1 milion euro) dhe Ferizaj (500 mijë euro). Tek Ministria e Shëndetësisë (MSH), si investim kapital i ri është paraparë studimi i fizibilitetit për paisje mjekësore me 2 milionë euro buxhet, si dhe ndërtimi në bashkëfinancim i qendrave për të moshuar dhe me aftësi të kufizuar me 300 mijë euro, dhe më shumë.

**Figura 9.** Investimet kapitale nga ministritë në 2020 (në euro)



**Ndarja e investimeve kapitale nga niveli qendror në komuna duket të jetë më e balancuar krahasuar në vitet e kaluara.** Investimet kapitale të ministrive në komuna sipas ligjit të buxhetit 2020 janë paraparë të kapin vlerën mbi 150 milionë euro dhe do të shpërndahen në 35 komuna. Meqë në buxhetin e vitit 2020, mbi 90% e projekteve kapitale janë vazhdimësi nga viti i kaluar, kur qeveria është udhëhequr nga një koalicion tjetër nga ky aktual, shpërndarja e investimeve nëpër komuna paraqet kryesisht preferencat dhe prioritetet për shpërndarje të atij koalicioni. Rreth 23% e këtij buxheti, do të investohet në tetë komunat e udhëhequra nga LDK ndonëse 28% e popullsisë së Kosovës jeton në këto komuna dhe ato mbulojnë 29% të tërë territorit të Kosovës. Në anën tjetër, dy komunat e udhëhequra nga PSD do të përfitojnë 23% të investimeve kapitale të ministrive ndonëse në këto komuna jeton vetëm 14% e popullsisë së Kosovës dhe ato mbulojnë 9% të territorit të Kosovës. Shtatë komunat e udhëhequra nga AAK do të përfitojnë së bashku rreth 20% të investimeve kapitale të ministrive në komuna. Rreth 18% e popullsisë jeton në këto komuna dhe ato mbulojnë së bashku 18% të territorit të Kosovës. Ndërsa, pesë komunat e udhëhequra nga PDK do të përfitojnë rreth 13% të këtij buxheti, e në të njëjtat jetojnë 15% e popullsisë së Kosovës dhe ato përbëjnë 13% të territorit të Kosovës. Ngjashëm, dy komunat e udhëhequra nga VV, në të cilat jeton 15% e popullsisë dhe mbulojnë 9% të territorit të Kosovës, do të përfitojnë 13% të investimeve kapitale të ministrive.

**Figura 10.** Investimet në komuna nga ministrinë



Komuna e Prishtinës, e udhëhequr nga PSD, është përfituesja më e madhe e investimeve kapitale nga ministrinë me rreth 21%, në të cilën jeton 12% e popullsisë së Kosovës dhe territori i saj është sa 5% e gjithë territorit të Kosovës. Pas saj, si përfituese e 8% të projekteve kapitale është Komuna e Ferizajt, e cila udhëhiqet nga PDK, dhe në të cilën jeton 6% e popullsisë dhe mbulon 3% të territorit të Kosovës. Komuna e Gjakovës është përfituesja e tretë më e madhe e investimeve kapitale të MIA me 7%, ku në këtë komunë jeton 5% e popullsisë dhe mbulon po aq territor të Kosovës. Bazuar në këta indikatorë, siç tregon Tabela 1, të diskriminuara negativisht sa i përket përfitimit nga këto investime kapitale të ministrive mbeten komuna e Prizrenit e udhëhequr nga VV dhe ajo e Podujevës e udhëhequr nga LDK. Po ashtu, të diskriminuara tërësisht janë edhe komuna e Leposaviqit, Parteshit, Kllokotit dhe Zubin Potokut që nuk do të përfitojnë ndonjë investim nga qendra.

Mbi 63 milionë euro të investimeve kapitale në komuna në 2020, do të realizohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit. Ngjashëm, sikurse vitin e kaluar, Komuna e Gjakovës e udhëhequr nga AAK është përfituesja më e madhe e investimeve kapitale nga MIA me rreth 11%. Pas saj, si përfituese e mbi 10% të projekteve kapitale është Skënderaj. Njëjtë sikurse vitin e kaluar, Komuna e Prizrenit e udhëhequr nga VV dhe ajo e Drenasit e udhëhequr nga PDK janë diskriminuar negativisht nga investimet e MIA në komuna.


**Tabela 1.** Investimet në komuna nga ministrinë

|                   | PËRQINDJA E INVESTIMEVE | PËRQINDJA E POPULLSISË | PËRQINDJA E SIPËRFAQËS | PARTIA E KRYETARIT  |
|-------------------|-------------------------|------------------------|------------------------|---------------------|
| Prishtinë         | 21%                     | 12%                    | 5%                     | PSD                 |
| Ferizaj           | 8%                      | 6%                     | 3%                     | PDK                 |
| Gjakovë           | 7%                      | 5%                     | 5%                     | AAK                 |
| Mitrovicë         | 7%                      | 4%                     | 3%                     | VV                  |
| Pejë              | 6%                      | 6%                     | 6%                     | LDK                 |
| Deçan             | 6%                      | 2%                     | 3%                     | AAK                 |
| Prizren           | 6%                      | 11%                    | 6%                     | VV                  |
| Skënderaj         | 5%                      | 3%                     | 3%                     | I pavarur           |
| Gjilan            | 5%                      | 4%                     | 4%                     | LDK                 |
| Vushtrri          | 5%                      | 4%                     | 3%                     | LDK                 |
| Drenas            | 3%                      | 3%                     | 3%                     | PDK                 |
| Suharekë          | 2%                      | 3%                     | 3%                     | AAK                 |
| Rahovec           | 2%                      | 3%                     | 3%                     | AAK                 |
| Lipjan            | 2%                      | 3%                     | 3%                     | LDK                 |
| Kamenicë          | 2%                      | 2%                     | 4%                     | PSD                 |
| Podujevë          | 2%                      | 5%                     | 6%                     | LDK                 |
| Istog             | 2%                      | 2%                     | 4%                     | LDK                 |
| Malishevë         | 2%                      | 3%                     | 3%                     | NISMA               |
| Viti              | 1%                      | 3%                     | 2%                     | LDK                 |
| Klinë             | 1%                      | 2%                     | 3%                     | AAK                 |
| Kaçanik           | 1%                      | 2%                     | 2%                     | PDK                 |
| Dragash           | 1%                      | 2%                     | 4%                     | PDK                 |
| Fushë Kosovë      | 1%                      | 2%                     | 1%                     | LDK                 |
| Mitrovicë Veriore | 1%                      | 1%                     | 0.1%                   | LS                  |
| Junik             | 1%                      | 0.4%                   | 1%                     | AAK                 |
| Shtime            | 0.5%                    | 2%                     | 1%                     | PDK                 |
| Hani i Elezit     | 0.4%                    | 1%                     | 1%                     | I pavarur           |
| Obiliq            | 0.4%                    | 1%                     | 1%                     | AAK                 |
| Shtërpcë          | 0.2%                    | 0.4%                   | 2%                     | LS                  |
| Mamushë           | 0.1%                    | 0.3%                   | 0.1%                   | KDTP                |
| Graçanicë         | 0.1%                    | 1%                     | 1%                     | LS                  |
| Novobërdë         | 0.1%                    | 0.4%                   | 2%                     | LS                  |
| Ranillug          | 0.1%                    | 0.2%                   | 1%                     | LS                  |
| Zveçan            | 0.1%                    | 0.4%                   | 1%                     | LS                  |
| Leposaviq         | 0%                      | 1%                     | 5%                     | LS                  |
| Partesh           | 0%                      | 0.1%                   | 0.3%                   | LS                  |
| Klllokot          | 0%                      | 0.1%                   | 0.2%                   | Iniciativa Qytetare |
| Zubin Potok       | 0%                      | 0.4%                   | 3%                     | LS                  |



**Është rritur buxheti i komunave.** Në vitin 2020, buxheti i ndarë për 38 komunat në Kosovë do të jetë mbi 568 milionë euro apo rreth 7% më i lartë se në vitin 2019. Rreth 409 milioën euro apo 72% e buxhetit të komunave në vitin 2020 është i destinuar për shpenzimet rrjedhëse, ndërsa 28% apo 159 milionë euro për shpezime kapitale. Përderisa, në vitin 2019, kategoria e shpenzimeve kapitale ishte rritur për 11% krahasuar me 2018, në vitin 2020 kemi ulje të buxhetit për këtë kategori krahasuar me 2019. Ndërsa, vërehet një trend i rritjes së shpenzimeve rrjedhëse, të cilat në periudhën 2019-2018 janë rritur për 7%, ndërsa në periudhën 2020-2019 për 11%. Ndikim në rritjen e shpenzimeve rrjedhëse në 2020 ka edhe rezerva e ndarë prej 34 milionë euro për komunat në rast se hyn në fuqi Ligji për paga.

**Figura 11.** Rritja e shpenzimeve rrjedhëse dhe kapitale të komunave, 2018-2020




**Buxheti për shëndetësi është rritur por është ende i ulët në proporcion me madhësinë e ekonomisë krahasuar me shpenzimet në vendet e BE-së.** Në 2020, buxheti i ndarë për sektorin e shëndetësisë është 233 milionë euro apo rreth 8.1% më i lartë se në vitin 2019 kur ishte 214 milionë euro. Koncretisht, krahasuar me 2019, në vitin 2020 është rritur buxheti i MSH për 13 milionë euro apo 33% dhe granti për shëndetësi për komuna për 8.3 milionë euro apo 16%, ndërsa është ulur buxheti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) për rreth 2.5 milionë euro apo 2%. Ulje të buxhetit për SHSKUK ka pasur në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale për rreth 4 milionë euro.

**Figura 12.** Buxheti për shëndetësi në Kosovë



Shuma e ndarë nga buxheti i vitit 2020 për shëndetësi si përqindje e BPV-së është 3.2% e BPV. Në Bashkimin Evropian (BE), vendet sikurse Danimarka ndajnë buxhet në vit për shëndetësi sa 8.3% të BPV, Suedia 7%, Italia 6.8% dhe Greqia 5%. Mesatarja që ndajnë 27 shtetet e BE-së për shëndetësi në vit është rreth 7% e BPV. Krahasuar me këto shtete, buxheti që ndan Kosova për shëndetësi si përqindje e BPV mbetet ende shumë i vogël dhe është i përafërt vetëm me atë Qipros, si shteti që ndan më pak nga 27 vendet e BE-së.


**Figura 13.** Buxheti për shëndetësi nga disa vende në Europë



BURIMI: EUROSTAT<sup>6</sup> DHE INSTITUTI GAP DUKE PËRDORUR TË DHËNAT E BUXHETIT 2020

**Janë rritur shpenzimet për sektorin e arsimit.** Në vitin 2020, bazuar në klasifikimin funksional, rreth 375 milionë euro apo rreth 16% e buxhetit të Kosovës do të destinohet për fushën e arsimit. Krahasuar me vitin paraprak, është rritur për 2 pikë përqindje shpenzimi për aktivitetet, trajnimet, investimet kapitale nga fusha e arsimit.

**Figura 14.** Shpenzimet në fushën e arsimit në Kosovë në 2020




BURIMI: INSTITUTI GAP DHE RAPORTI I MFT<sup>7</sup>

<sup>6</sup> EUROSTAT. Databaza e të dhënave lidhur me shpenzimin e shteteve të BE në shëndetësi. Burimi: <https://bit.ly/2Yypz0V>

<sup>7</sup> Ministria e Financave dhe Transfereve. Raporti vjetor financiar 2019 (i paaudituar). Burimi: <https://bit.ly/2wssSLH>

Buxheti i ndarë nga Qeveria e Kosovës për sektorin e arsimit bazuar në klasifikimin funksional të buxhetit në vitin 2020 është rreth 5% e BPV. Kjo përqindje është përafërsisht e ngjashme me ato që ndajnë Franca (5.1% e BPV), Polonia (5% e BPV) dhe Austria (4.8% e BPV). Mesatarja e buxhetit të ndarë për arsim në BE është rreth 4.6% e BPV.

**Figura 15.** Buxheti për arsim si përqindje e gjithsej buxhetit, në disa vende në Europë



BURIMI: EUROSTAT<sup>8</sup> DHE INSTITUTI GAP DUKE PËRDORUR TË DHËNAT E BUXHETIT 2020

**Është rritur buxheti për disa pensione.** Për dallim nga e kaluara, në 2020 komponenta e skemave sociale ka kaluar nga Ministria e Punës dhe Mbrojtjes Sociale e cila nuk është më si ministri e vecantë, tek Ministria e Financave dhe Transfereve. Shuma e ndarë për pensionet dhe kompensimet tjera sociale në vitin 2020 është mbi 458 milionë euro që është për 4% apo rreth 18 milionë euro më e lartë se në vitin paraprak. Për gjysmën e programeve nuk ka ndryshuar buxheti nga viti i kaluar, ndërsa rritje të buxhetit kishte për pensionet kontributdhënëse (8.8 milionë euro apo 7.9%), pensionet bazike (6.6 milionë euro apo 4.8%), pensionet e vetëranëve (4.1 milionë euro apo 7.1%) dhe pensionet e pjesëtarëve të FSK (1.4 milionë euro apo 99.6%).

Por, mbetet e rëndësishme të analizohet në fund të vitit se çfarë do të ndodhë me kategorinë e pensioneve të veteranëve, ku në vitet e kaluara ka pasur devijim të madh nga shuma e planifikuar. Koncretisht, në buxhetin e vitit 2019 ishin ndarë 58 milionë euro për këtë kategori mirëpo përgjatë vitit janë alokuar mjete shtesë, ku shuma e shpenzuar në fund të 2019 ishte rreth 77 milionë euro apo 33% më e lartë se planifikimi.<sup>9</sup>

<sup>8</sup> EUROSTAT. Databaza e të dhënave lidhur me shpenzimin e shteteve të BE në arsim. Burimi: <https://bit.ly/2Yypz0V>


<sup>9</sup> Ministria e Financave dhe Transfereve. Raporti vjetor financiar 2019 (i paaudituar). Burimi: <https://bit.ly/2wssSLH>

**Figura 16.** Pensionet dhe kompenzimet 2019-2020

|   | 2019          | 2020          |
|---|---------------|---------------|
| Pensioni Invalidor i Punës                        | 720,000 €     | 378,000 €     |
| Zbatimi i Ligjit Nr.04/L-054                      | 1,000,000 €   | 1,000,000 €   |
| Provizionet Bankare për Pagesën e Skemave Sociale | 1,200,000 €   | 1,200,000 €   |
| Pensionet e Parakohshme (TMK)                     | 2,785,000 €   | 2,785,000 €   |
| Pensionet e Pjestarëve të FSK                     | 1,403,000 €   | 2,800,000 €   |
| Pensionet e Parakohshme(Trepça)                   | 5,300,000 €   | 4,350,000 €   |
| Pagesa për Komunalit për Raste Sociale            | 4,500,000 €   | 4,500,000 €   |
| Pensioni Familjar                                 | 6,193,697 €   | 5,110,000 €   |
| Kompenzimi për të Verbërit                        | 5,500,000 €   | 5,500,000 €   |
| Kompenzimi për të Burgosurit Politik              | 5,500,000 €   | 5,500,000 €   |
| Paraplegjikët dhe Tetraplegjik                    | 12,401,000 €  | 12,401,000 €  |
| Pensionet e Aftesisë së Kufizuar                  | 17,100,000 €  | 17,100,000 €  |
| Ndihmat Sociale                                   | 29,000,000 €  | 28,780,000 €  |
| Pensionet për Invalidët e Luftës                  | 39,505,527 €  | 39,505,527 €  |
| Pensionet e veteranëve                            | 57,911,776 €  | 62,000,000 €  |
| Pensionet Kontributdhënës                         | 111,121,647 € | 119,946,400 € |
| Pensionet Bazike-Sociale                          | 138,814,426 € | 145,448,720 € |

Është rritur buxheti i agjencive të tregut të punës. Në vitin 2020, Agjencia e Punësimit do të ketë buxhet prej 11.1 milionë euro rreth 500 mijë euro (4.7%) më shumë se në vitin paraprak. Koncretisht, rritje të buxhetit ka pasur për programin e shërbimeve të punësimit në këtë agjenci për rreth 716 mijë euro apo 8%, ndërsa është zvogëluar buxheti i programit të shërbimeve të aftësisimit profesional për rreth 216 mijë euro apo 18%. Kurse, buxheti i Inspektoratit të Punës në vitin 2020 do të jetë mbi 823 mijë euro apo 6.5% më i lartë se në vitin 2019. Rritja e buxhetit për këtë institucion është bërë në kategorinë e shpenzimeve kapitale, për rreth 65 mijë euro më shumë, ndërsa ka ulje të lehtë për kategoritë e pagave dhe mëditjeve dhe mallrave dhe shërbimeve për rreth 10 mijë dhe 5 mijë euro, respektivisht. Megjithëse në programin e qeverisë, ishte premtuar staf prej 400 personash për këtë inspektorat, në buxhetin e vitit 2020 parashihet që ky institucion t'i ketë 90 të punësuar.<sup>10</sup>

**Figura 17.** Buxheti për institucionet e tregut të punës, 2020



**Mbi 9.2 milionë euro subvencione për përkrahjen direkte të ndërmarrësisë.** Në 2020, janë dy programe në buxhet që parashohin subvencionimin e ndërmarrësisë. Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrësisë e cila është bartur dhe funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, kurse më parë ishte pjesë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka të ndara rreth 7.2 milionë euro si subvencione dhe programi i Ndërmarrësisë në kuadër të MEPTINIS parasheh ndarjen e mbi 2 milionë euro subvencione për këtë fushë.

**Ndryshime të vogla në buxhetin e institucioneve që mbikëqyrin cilësinë e produkteve në treg.** Buxheti i ndarë për shumicën e departamenteve dhe agjencive që mbulojnë fushën e tregtisë dhe industrisë ka mbetur i njëjtë si në vitin paraprak. Institucionet që përpilojnë politikat për sektorë të ndryshëm, mbikëqyrin cilësinë e produkteve në treg, dhe më shumë, zvogëlim më të theksuar të buxhetit ka pasur për departamentin e industrisë, ku nga 377 mijë euro sa kishte në 2019 tani do të ketë rreth 120 mijë euro. Siç dihet, ky departament por edhe institucionet tjera të prezantuara në Figurën 18, tani veprojnë nën ombrellën e MEPTINIS në të cilën është shkrirë Ministria e Industrisë dhe Tregtisë. Buxheti vjetor i institucioneve tjera sikurse i Inspektoratit të Tregut, Departamenti i Tregtisë, dhe më shumë, nuk është ndikuar pozitivisht apo negativisht përtej vlerës 9,800 euro.

<sup>10</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2020 – 2023, Burimi: <https://bit.ly/2VYYmCU>




**Figura 18.** Buxheti për institucionet e monitorimit të tregut, 2020



**Është rritur buxheti për disa institucione kyçe të sistemit të drejtësisë.** Në vitin 2020, janë ndarë mbi 76 milionë euro për pesë institucione që mbulojnë fushën e drejtësisë, ku Ministrisë së Drejtësisë (MD) i janë ndarë rreth 30 milionë euro, Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) rreth 30 milionë euro, Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) mbi 15 milionë euro, Akademisë së Drejtësisë (AD) mbi 960 mijë euro dhe Agjencionit Anti-Korrupsion (AKK) rreth 572 mijë euro. Krahasuar me vitin 2019, buxheti për këto institucione këtë vit është rritur për 10% apo 7.1 milionë euro. Në buxhetin e MD-së, kategoria e subvencioneve është rritur më ndjeshëm, për 4.8 milionë euro, ku thuajse e gjithë shuma e kësaj kategorie (6.5 milionë euro) është e destinuar për te personat të akuzuar potencial nga Gjykata Speciale. AD do të ketë buxhet më të vogël në vitin 2020 për rreth 470 mijë euro, ku kryesisht janë ulur shpenzimet kapitale për këtë institucion. Kurse, buxheti i KPK dhe KGJK është rritur për 6% dhe 1.4%, respektivisht. Për të gjitha këto institucione është rritur numri i punonjësve, përjashtimisht për AKK që nuk ka ndryshuar numri i lejuar, që institucionet mund të angazhojnë këtë vit. Është e rëndësishme që për dy institucione të rëndësishme të drejtësisë, Këshillin Prokurorial dhe atë Gjyqësor, ndryshimi i kufirit për numrin e lejuar të punonjësve është përcjellë me buxhet shtesë të mjaftueshëm për paga dhe mëditiye, 754 mijë dhe 822 mijë euro respektivisht. Ndërsa, për institucionet tjera ka rënie të kategorisë së pagave dhe mëditiëve.

**Figura 19.** Buxheti i disa institucioneve të drejtësisë në 2020



**Është ulur buxheti i Radio Televizionit të Kosovës (RTK) për 20%.** Edhe në vitin 2020 do të vazhdojë financimi i RTK-së nga buxheti publik. Këtë vit, buxheti i RTK-së do të jetë 8.96 milionë euro apo 20% (2.24 milionë euro) më i ulët se në vitin 2019. Ky financim është i kushtëzuar pasi që, bazuar në Ligjin e buxhetit 2020, RTK duhet të dorëzojë çdo tre muaj raportin e shpenzimeve tek Komisioni parlamentar i buxhetit dhe transfereve. Pastaj, sipas vendimit të këtij komisioni, do të bëhet edhe alokimi i mjeteve.

# Përfundim

Situata e krijuar politike pas zgjedhjeve të fundit parlamentare në Kosovë dhe formimi i qeverisë në shkurt 2020 bëri që edhe buxheti për vitin 2020 të aprovohet me vonesë. Qeveria e re kishte ri-organizuar ministrinë duke ulur numrin e tyre në 15 sosh, çfarë ka bërë që të ndryshojë edhe buxheti i ndarë për secilën nga këto ministri. Tri ministrinë me buxhetin më të madh janë Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT), Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP) dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit (MIA).

Shpenzimet vjetore parashihen të jenë më të larta se të hyrat, rrjedhimisht është rritur deficitin buxhetor. Mirëpo, për dallim prej vitit të kaluar, pritet një rritje më e shpejtë e investimeve kapitale krahas shpenzimeve rrjedhëse.

Prioritetet sipas fushave të shpenzimeve kanë mbetur të njëjta me vitin e kaluar, mirëpo këtë vit është vërejtur një rënie më e theksuar e buxhetit për ndërtim të autostradave dhe rehabilitim të rrugëve. Ndërsa, për dallim nga viti 2019, këtë vit shihet një shpërndarje më e balancuar e investimeve të nivelit qendror në komuna. Buxheti për shëndetësi është rritur, por jo mjaftueshëm nëse e krahasojmë me shpenzimet në vendet e BE-së, duke marrë për bazë shpenzimet në raport me BPV-në. Edhe buxheti për arsim është rritur krahasuar me vitin paraprak dhe, në raport me madhësinë e ekonomisë së Kosovës, del të jetë i ngjashëm me atë që ndajnë disa vende të mëdha të BE-së.

Buxheti për RTK-në ka rënë dhe alokimi i mjeteve i është kushtëzuar me raportim të rregullt të shpenzimeve tek Komisioni parlamentar i buxhetit dhe transfereve.

Sidoqoftë, buxheti është miratuar para pandemisë COVID-19 dhe ky raport analizon ex-post ndarjet fillestare. Një analizë e prioriteteve të reja të buxhetit të vitit 2020 pas përhapjes së pandemisë COVID-19 do të bëhet nga Instituti GAP në muajt në vazhdim.



Instituti GAP mbështetet nga:

